

REPUBLIKA E KOSOVËS  REPUBLIKA KOSOVA  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  VRHOVNI SUD KOSOVA  
G.J.A-Su.A 62/2016  
Dt: 18.02.2016  
PRISHTINË - PRIŠTINA



**GJYKATA SUPREME E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**  
**VRHOVNI SUD REPUBLIKE KOSOVA**  
**SUPREME COURT OF THE REPUBLIC OF KOSOVA**



Mbledhja e Përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës në të cilën ishin të pranishëm edhe gjyqtarët dhe përfaqësuesit tjerë nga EULEX-i, në bazë të nenit 22 të Ligjit për Gjykatat e Rregullta, më 01.02.2016 jep këtë:

**MENDIM JURIDIK**

**Departamenti i përgjithshëm i gjykatave themelore ka kompetencë lëndore dhe vendore për të vendosur për propozimin për kthimin në gjendjen e mëparshme vetëm në rastet e mos ruajtjes së afateve për paraqitjen e prapësimit dhe ankesës kundër vendimeve për përmbarrimin e detyrueshëm.**

**ARSYETIMI**

1. Duke qenë se janë paraqitur disa paqartësi, vështirësi dhe dilema edhe në Gjykatën Themelore në Prizren lidhur me çështjet juridike përmbarrimore edhe atë se:
  - a) në cilën fazë të procedurës organi përmbarrues ka kompetencë për të përmbarruar urdhrin përmbarrimor me rastin e paraqitjes së prapësimit apo të ankesës.
  - b) kush është kompetent për të vendosur sipas propozimit për kthimin në gjendjen e mëparshme në rastet e mos ruajtjes së afateve për paraqitjen e prapësimit dhe ankesës kundër vendimeve për përmbarrimin e detyrueshëm.
2. Prandaj, sipas nenit 22 par. 1 nënpar.3 dhe nenit 23. par 1 të Ligjit për gjykatat, Seanca e Përgjithshme e Gjykatës Supreme ka kompetencë të bëjë njësimin e praktikës juridike gjyqësore

dhe të promovojë zbatimin unik të ligjeve duke ndërtuar standarde dhe praktika të qëndrueshme juridike.

3. Zgjidhja e dilemave, paqartësive lidhur me këto çështje juridike përmbartimore ka rëndësi kruciale në njësimin e praktikës juridike – gjyqësore, në promovimin e ndërtimit të standardeve, praktikave të qëndrueshme juridike dhe, rrjedhimisht në forcimin e kredibilitetit dhe imazhit dhe reputacionit të gjyqësorit të Republikës së Kosovës me synim për të arritur sigurinë juridike të palëve, stabilitetin e rendit juridik dhe rrjedhimisht funksionimin efikas – efektiv të shtetit të së drejtës.
4. Efekti juridik i ndërtimit të këtyre standardeve dhe praktikave të njësuara dhe të qëndrueshme juridike konsiston në performancën pozitive të gjyqësorit duke përfshirë edhe pritshmërinë dhe kënaqshmërinë e palëve dhe të qytetarëve si dhe rrjedhimisht lidhur me te për krijimin e ambientit stabil ekonomik për investitorët vendor dhe të huaj.
5. Me dispozitën e nenit 68, të LPP parashikohen mjetet e jashtëzakonshme juridike, ndërkaq, në paragrafin 2 të kësaj dispozite ligjore i referohet çështjeve juridike përmbartimore ku parashikohet se kthimi në gjendjen e mëparshme është i lejuar vetëm në rastet e mos ruajtjes së afateve për paraqitjen e prapësimit dhe ankesës kundër vendimeve të pambarueshme për përmbartimin me dhunë. Prandaj, me pa mëdyshje dhe në mënyrë të sigurt rezulton konkludimi juridik i drejtë dhe i ligjshëm se sipas propozimit për kthimin në gjendjen e mëparshme vendos gjykata themelore me kompetencë vendore dhe lëndore.
6. Përpos kësaj, sipas dispozitës së nenit 130, par. 1 të LPK parashikohet:

Citat;

*“Propozimi për kthimin në gjendje të mëparshme i paraqitet gjykatës, në të cilën është dashur të kryhet veprimi procedural i pakryer.”* mbarim citati.


Pra, kjo dispozitë ligjore sipas nenit 19 të LPP zbatohet *mutatis mutandis* apo subsidiarisht në procedurën përmbartimore.

7. Duke bërë interpretimin kritik, kreativ përmbajtësor të këtyre dispozitave ligjore rezulton konkludimi juridik se për të vendosur sipas propozimit për kthimin në gjendjen e mëparshme

për prapësim dhe ankesë, atëherë kompetente lëndore dhe vendore është gjykata themelore sipas selisë së debitorit.

8. Përkitazi me paraqitjen e dilemave se në cilën fazë të procedurës organi përmbarues ka kompetencë për të përmbaruar urdhrin përmbarimor me rastin e paraqitjes së prapësimit apo të ankesës Seanca e Përgjithshme e Gjykatës Supreme konsideron se kjo dilemë është saktësuar, qartësuar në mënyrë të mjaftueshme me dispozitat e nenit 74, 77, par.5 dhe 78 të LPP. Kjo pikërisht për arsye se me dispozitën e nenit 74 të LPP parashikohet se vendimi kundër të cilit nuk është paraqitur prapësimi brenda afatit ligjor, bëhet i formës së prerë dhe i përmbarueshëm. Ndërkaq, vendimi kundër të cilit është refuzuar prapësimi bëhet i përmbarueshëm, e po që se kundër tij nuk lejohet ankesa, ai bëhet i formës së prerë. Po ashtu, me këtë dispozitë ligjore parashikohet se vendimi me të cilin refuzohet prapësimi bëhet i formës së prerë, po që se kundër tij nuk paraqitet ankesë brenda afatit ligjor, ose në qoftë se ankesa refuzohet si e pathemeltë.
9. Ndërkaq, me dispozitën e nenit 77, par. 5 parashikohet se ankesa kundër vendimit nuk e ndalon procedurën përmbarimore, përveç nëse janë dhënë garancitë siç parashikohet me dispozitën e nenit 78 të këtij ligji.
10. Rrjedhimisht mbi të mësipërmen janë dhënë shpjegime, sqarime të drejta, të qarta të kuptueshme dhe të ligjshme për çështjet e parashtruara në kërkesën e Gjykatës Themelore në Prizren.

Prof. Dr. Fejzullah Hasani



Kryetar i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës